



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 93, datë 30.03.2023

PËR

MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN 1 BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 118, DATË 27.10.2022, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 5, RRUGA "DAVID SELENICA", PALLATI NR. 18, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë" të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019, "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", të ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 "Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës", i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr.164, datë 26.05.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit" i ndryshuar me Urdhërin nr.222, datë 06.07.2020, Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr.104, datë 08.07.2022, Raportit me nr. 3113/1 prot. datë

24.03.2023 të Komisionit të Posaçëm si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e disa shtesave në Aneksin 1, "Subjektet përfituese të pallatit nr.18, rruga "David Selenica" bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 118, datë 27.10.2022, për sa i përket listës së përfituesve për pallatin nr.18, rruga "David Selenica", në Njësinë Administrative nr.5, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, hartuar nga Komisioni i Posaçëm sipas tabelës, pjesë përbërëse e këtij vendimi, si më poshtë vijon:

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURAE APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
10	ANITA SULA	3	2+1

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 05.04.2023



BASHKIA DURRES
12.04.23 Nr. 2560/13

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRES

Nr. 240/prot.
3

Durrës, më 12.04.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRES
KRYETARIT TË BASHKISË
DURRES**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.93 datë 30.03.2023 “Për miratimin e një shtese në aneksin 1, bashkëlidhur vendimit të këshillit bashkiak nr. 118, datë 27.10.2022, përsa i përket listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në njësinë administrative nr. 5, rruga "David Selenica", pallati nr. 18, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

